

DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME  
TË KOSOVËS PËR  
ÇËSHTJE QË LIDHEN  
ME AGJENCINË  
KOSOVARE TË  
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF  
THE SUPREME COURT  
OF KOSOVO ON KOSOVO  
TRUST AGENCY  
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODRNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU  
AGENCIJU

SCA-08-0065

*Paditësi*

██████████, Podujevë  
Person fizik – përfaqësuar nga ██████████, avokat në Prishtinë

kundër

*Të Paditurit*

1. Kombinati Bujqësor ██████████  
Fshati Sfeqël, Podujevë
2. ██████████  
Person fizik

*Ankuesi*

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit - AKM,  
Përfaqësuar nga UNMIK-ut

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, nën-paneli i përbërë nga Piero Leanza, si Gjyqtar Kryesues dhe Laura Plesa, Gjyqtare, sipas vendimit të Trupit Gjykses për delegimin e kompetencave në bazë të nenit 8.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 dhe nenit 11.1 – 11.4 të UA UNMIK-ut 2008/6, më 25 qershor 2010 lëshon këtë:

### AKTGJYKIM

1. Ankesa e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) është e bazuar.
2. Anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Podujevës, nr. 42/06, i datës 17 maj 2007, kundër të cilit është ngritur ankesa.

#### Rrethanat procedurale dhe faktike:

Më 5 qershor 2008, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Podujevës (C. nr. 42/06), të datës 17 maj 2007, me të cilin ishte vërtetuar se Paditësi ██████████ e kishte fituar të drejtën e

pronësisë mbi një pronë të paluajtshme, të përbërë nga disa ngastra kadastrale, dhe të blerë nga i Padituri [REDAKTUAR] Kombinati Bujqësorë, përmes një kontrate të shitblerjes të lidhur në vitin 1997.

AKM-ja në ankesën e saj pohon se Gjykata Komunale nuk ishte juridiksionin për të dëgjuar dhe gjykuar padinë, pasi që çështja lëndore parashihet me nenin 4.1. (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 dhe kështu ishte nën juridiksion parësor të Dhomës së Posaçme. Juridiksioni i Gjykatës Komunale mund të jetë dhënë vetëm me ndonjë vendim për referim të Dhomës së Posaçme, në bazë të nenit 4.2 të Rregullores së lartpërmendur. Prandaj, pasi që Dhoma e Posaçme nuk e ka referuar asnjëherë këtë lëndë, Gjykata Komunale është dashur të deklarohet jokompetente, sipas nenit 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe nenit 15 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. AKM-ja, më tutje, shprehu shqetësimin e saj se provat e dorëzuara në gjykimin e shkallës së parë në mbështetje të padisë së tij nuk ishin të vërteta.

Në përgjigjen e tij ndaj ankesës, Paditësi kërkoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar, pasi që aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Podujevës është i bazuar në merita dhe nuk është në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara me nenin 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe nenit 15 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Sipas Paditësit, kontrata e kontestuar nuk ka të bëjë me ndonjë pronë në juridiksionin e AKM-së dhe ajo ishte nënshkruar para se AKM-ja të kishte marrë kontrollin e saj administrativ. Prandaj, Gjykata Komunale ishte kompetente për të gjykuar lëndën.

Dhoma e Posaçme, duke marrë parasysh që AKM-ja, e cila është në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte një prej palëve në këtë lëndë, i kishte të pezulluara operimet e saj, me Aktvendimin e datës 31 korrik 2008 ndali procedurën në këtë lëndë.

Me Aktvendimin e datës 21 janar 2010 u hoq pezullimi dhe me Urdhrin e datës 29 mars 2010 Dhoma e Posaçme kërkoi nga Gjykata Komunale e Podujevës që të sjellë në Gjykatë dosjen complete origjinale C. nr. 42/06.

### **Arsyet ligjore:**

Ankuesi, AKM, ishte – në kohën e ushtrimit të padisë para Gjykatës Komunale të Podujevës – administrues i Ndërmarrjes Shoqërore dhe pronës shoqërore. Më 21 maj 2008 AKM-ja pranoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Podujevës. Prandaj, AKM-ja në mënyrë korrekte ushtroi ankesë pranë Dhomës së Posaçme më 5 qershor 2008 (brenda dy muajve, siç parashihet me UA UNMIK-ut 2006/17), në emër të dhe në përfaqësim të interesave të NSH [REDAKTUAR], Podujevë.

Ankesa është ushtruar në Dhomën e Posaçme sipas neneve 55 dhe 56 të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2006/17 (tani shih nenet 58 dhe 59 të UA UNMIK-ut

2008/6). Nenet e lartpërmendura ishin në fuqi në kohën kur u lëshua aktgjykimi i Gjykatës Komunale dhe kur u ushtrua ankesa e të Paditurit (shih për këtë pikë, për shembull, Aktvendimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme ASC-09-0013, të datës 14 maj 2010).

Sipas nenit 5.1 (a) (ii) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/18 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, Agjencia ka kompetenca që të administrojë çfarëdo pasurie të vendosur në territorin e Kosovës (pavarësisht a është organizuar në subjekt apo jo) e cila ka përfshirë pasuri në pronësi shoqërore prej 22 marsit 1989 apo ndonjë date të mëvonshme (pavarësisht a i është nënshtruar transformimit apo jo).

Në këtë rast, nuk kontestohet se prona që është objekt i padisë ishte e regjistruar në emër të NSH [REDAKTUAR]

Neni 4.1 (d) i Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 parashikon që Dhoma e Posaçme ka juridiksion parësor për: *“kërkesat që përfshijnë njohjen e një të drejte, një titulli apo interesi pronësor që është në posedim apo nën kontrollin e një ndërmarrjeje a korporate që aktualisht është ose ka qenë më parë nën autoritetin e Agjencisë kur kërkesat e tilla kanë lindur gjatë kohës ose para kohës kur ndërmarrja apo korporata e tillë i është nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë”*.

Për këtë arsye, nuk është relevant faktori që kontrata ishte nënshkruar nga palët në vitin 1997, para se AKM-ja të ishte operative, sepse ajo çka është relevante në çështjen lëndore është koha kur është ngritur padia, e që në këtë rast ishte në vitin 2006.

Neni 4.2 i Rregullores së lartpërmendur thotë si në vijim: *“Pavarësisht nga neni 4.1, Dhoma e veçantë mund t’ia bartë kërkesat e veçanta, kategoritë e pretendimeve ose pjesë të tyre cilëso gjykatë që ka juridiksion për atë çështje sipas ligjit në fuqi. Asnjë gjykatë nuk mund të ushtrojë juridiksion për ndonjë pretendim që përfshin lëndën e përshteruar në nenin 4.1, përveç nëse një pretendim i tillë është paraqitur në pajtim me këtë nen.”*

Në lëndën në fjalë, Paditësi asnjëherë nuk e ka ushtruar padinë pranë Dhomës së Posaçme dhe Dhoma e Posaçme asnjëherë nuk e ka referuar lëndën në Gjykatën Komunale të Podujevës.

Gjykata Komunale e Podujevës, e cila ka lëshuar aktgjykimin mbi të cilin është ngritur ankesa, i shkeli rregullat e përcaktuara me nenin 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 si dhe me nenin 15 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, i cili parasheh se *“Gjykata vlerëson kryesisht, menjëherë pas marrjes së padisë, nëse është kompetente dhe në cilën përbërje është kompetente”*. Prandaj, Gjykata Komunale është dashur të ketë refuzuar juridiksionin e saj.

Për arsyet e lartpërmendura u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**Këshillë juridike:**

Në bazë të nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ankesa kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet me shkrim tek Kolegji i Ankesave pranë DHPGJS-së brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi.

Piero Leanza, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it [nënshkruar]

Laura Plesa, Gjyqtare e EULEX-it [nënshkruar]

Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it [nënshkruar]